

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**  
**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/06/2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË**  
**(PROCEDURË E HAPUR)**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE**  
**PËR KUALIFIKIM.**

I mbajtur sot në datë 18.06.2026 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës i emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit me Nr. 579/1 Prot datë 18.06.2026 për procedurën e prokurimit e Hapur-Punë me objekt: **“Ndërtim i linjës 35kV Kavajë – Rrogozhinë, shtylla me dy qarqe, (1x240mm<sup>2</sup>)”**.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Linja të energjisë elektrike 31321100-3.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 299,991,644.15 (Dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e katër presje pesëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

**Argumentimi:** Per realizimin e ketij projekti pasi eshte bere zgjidhja tekniko ekonomike duke analizuar disa variante eshte bere zgjidhja perfundimtare e projektit dhe jane nxjerre materialet dhe pajisjet e nevojshme per kete fuqizim, si dhe volumet e punimeve civile, konstruksione mekanike, elektrike TU etj per te cilat jane perdorur çmimet e sistemit SAP te OSSH, kontrata per punime të ngjashme të realizuara në projektet e fundit dhe cmimet e analizave sipas e-Albania per punimet e parashikuara.

*Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në: Nenin 42 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, autoriteti kontraktor zhvillon një procedurë të hapur për kontratë të tipit “me çelësa në dorë”, që përfshin projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin funksional të objektit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

## **OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

### **OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që vepron si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

## **OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

---

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.***

*Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8).

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga ana e tyre gjatë tre viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Vlera e xhiros për të paktën

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit. *(Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.3** Afati i punimeve për realizimin e ketyre punimeve do të jete 20 muaj nga data e lirimimit të sheshit.

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si vijon:

**2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht  $299,991,644.15 \times 50\% = 149,995,822.07$  lekë ( pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

## **OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht  $299,991,644.15 \times 2 = 599,983,288.30$  lekë ( pa TVSH ).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartë vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer) shoqëruar me:

- ✓ Kontratë Sipërmarrje;
- ✓ Situacionin përfundimtar;
- ✓ Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
- ✓ Aktin e kolaudimit;
- ✓ Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- ✓ Vertetim leshuar nga subjekti privat, shoqëruar me:
- ✓ Kontrate Sipërmarrje;
- ✓ Situacionin përfundimtar;
- ✓ Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
- ✓ Akt kolaudimi objekti.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :  
 $299,991,644.15 \times 50\% = 149,995,822.07$  Njëqind e dyzet e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e njëzet e dy lekë e shtatë qindarka.

$299,991,644.15 \times 2 = 599,983,288.30$  Pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë million e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e duqind e tetëdhjetë e tetë lekë e tridhjetë qindarka.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

### 2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P. - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- N.P. - 2 A** Ndërtime civile dhe industriale;
- N.P. - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
- N.P. - 11 E** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S. - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- N.S. - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- N.S. - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me Material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- N.S. - 14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- N.S. - 18 A** Punime topogjeodezike.

Liçensa profesionale ne fushen e projektit:

- Kateg. 10. d** Projektim nënstacione elektrike, primar, sekondar – linja te tensionit te larte
- Kateg. 3.a 3b** Projektim konstruktor
- Kateg. 4 . c** Projektim instalator

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht: Kategoritë e licencave janë përcaktuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohet të realizohen në funksion të përmbushjes së qëllimit të kontratës, ndërsa klasifikimi i tyre, sipas niveleve (gërmave) përkatëse është përcaktuar në klasifikimin bazë (A) pasi volumet e punës që do të realizohen janë vetëm sasi / punime të planifikuara dhe N.P.- 11 E ne baze te volumit te punimeve.

**N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë” konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për gërmime per ndertesën e re te N.Stacionit, kanale kablllo, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

➤ Zërat dhe volumet sipas preventivit.

Punime gërmimi		
Gërmim dheu gropa shtyllash T/L, toke mes kat III, ~ 2.5 m, sip tabani 4 m <sup>2</sup>	m <sup>3</sup>	2850.00
Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , hapje rruge gjeresi deri 2-3 m, toke zak, kategoria III	m <sup>3</sup>	10475.00

**N.P. - 2 A Ndërtime civile dhe industriale;**

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 2 A Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për objektin ndertese e re, bazamente te pajisjeve te N.Stacionit, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Ndertime civile dhe industriale		
Beton i varfer C16/20	m <sup>3</sup>	116.260
F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	4.074
F.V. hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	51.192
Struktura monolite betoni C 20/25	m <sup>3</sup>	551.000
Shtrese betoni C 12/15	m <sup>3</sup>	3.33
F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.05

**N.P. - 3 A “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 3 A “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash” konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve ne fasada ekzistuese dhe te reja, për objektin ndertese ekzistuese dhe e re te N.Stacionit, konkretisht për punimet si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale		
Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)	m <sup>2</sup>	35.00

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Prishje suvatim i jashtem	m <sup>2</sup>	81.60
Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m <sup>2</sup>	81.60
Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m <sup>2</sup>	35.00
Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm per pjerresi	m <sup>2</sup>	35.00
Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	m <sup>2</sup>	35.00
Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	26.00
Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	14.00
Boje hidroplastike cilesi e larte	m <sup>2</sup>	81.60

**N.P. - 11 E “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 11 E “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike” konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme elektrike si ne pajisjet e tensionit te larte, te mesem TU, ne N.Stacion dhe në ndërtesat e tij si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike		
F.V. Shtylla metalike 110 kV, dopio qark te zinguar me bullona	ton	338.88

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Punime izolacioni 35 kV terheqes tek TT + morsete terh. ne shtylla ankerore (1 qark i montuar), 1x4 izolatore 12t	shtylle	10.5
Punime izolacioni 35 kV terheqes dopjo TD + morsete terh. ne shtylla ankerore (1 qark i montuar), 2x4 izolatore 12t	shtylle	2.5
Punime izolacioni 35 kV vares tek VT +morset mbajt. ne shtylla ndermjetese (1 qark i montuar), 1x3 izolatore 12t	shtylle	35
Punime izolacioni 35 kV vares dopjo VD +morset mbajt. ne shtylla ndermjet (1 qark i montuar), 2x3 izolatore 12t	shtylle	7
Shtrirje e terheqje 3 fije teli (percjellesa) me makineri, ACSR me seksion 240/40 mm <sup>2</sup>	km	17.50
F.V. denfera ne linjat T/L 110kV ne shtylla ndermjetese (1 qark i montuar)	shtylle	42
F.V. denfera ne linjat T/L 110kV ne shtylla ankerore tel terhequr (1 qark i montuar)	shtylle	13
Shtrirje terheqje Troshi OPGW 63 mm <sup>2</sup> 24 fije ,Tipi G652	km	17.50
F.V. morseteri mbajttese per OPGW , ne linja 110 kV	shtylle	42
F.V. morseteri terheqesee per OPGW , ne linja 110 kV	shtylle	13
F.V Demfer per OPGW 63 mm <sup>2</sup>	shtylle	55
F.V Joint Box per OPGW	cope	7
Tokezim Troshi per linja T/L 100 kV	shtylle	55
Pergatitje e vendosje tabela sinjalizimi	shtylle	55
F.V. shirit togezimi St/Zn 40x4 mm perfshi matjen e rezistences per shtyllat	ton	4.455
F.V ne tub dhe konstruksione metalike kabell Al, XLPE, 35kV (1x300/25 Cu) mm <sup>2</sup> per lidhjen kabllore 35kV.	ml	3600.00
F.V Shkarkues 35kV, nje polar	cope	12
F.V. Koka kablli 35 kV 1x(150-400)mm <sup>2</sup> te jashtme / brendshme	cope	12
Kenotrimi i kabllave dhe kokave te kabllit	cope	12
F.V. Tuba metalik spesor 3mm D=80mm (Tub mbrojtes kablli ne shtylle 2.5m/nje cope x 6 cope)	ml	15.00

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

F.V. shirit sinjalizimi per kablllo	ml	200.00
F.V. Kaprikorde CU-AL per zbritjen e kabllit te tokezimit CU-70mm <sup>2</sup>	cope	20
F.V. Percjelles Cu 50mm <sup>2</sup> zbrites + kontur tokezimi	ml	100.00
F.V. Elektrode tokezimi profil zingato e bakerizuar L=1.5 m	cope	10

**N.S – 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”, konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore që paraprihen nga punimet e prishjes, konkretisht për punimet si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime Prishjeje		
Prishje suvatim muri brenda	m <sup>2</sup>	50.20
Prishje suvatim solete (h<4m)	m <sup>2</sup>	19.50
Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve)	m <sup>2</sup>	1.74

**N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre” konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime hidraulike dhe hidrosanitare		
F.V ËC allaturka	cope	1
F.V lavaman porcelani	cope	1
F V bolier 80 liter, uje te ngrohte	cope	1
FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	ml	20.00
F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi	ton	0.03
F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi	ton	0.03
F.V Tuba e rakorderi PVC	kg	5.00
F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	cope	1

**N.S – 4 - A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese” konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për grup punimet si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Punime dyer dhe dritare rifiniture		
F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m <sup>2</sup>	3.90
F V dyer d/alumini plastike me dopio xham akulli	m <sup>2</sup>	1.70
F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m <sup>2</sup>	4.70
F.V davancale mermeri	m <sup>2</sup>	1.60

**N.S - 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 14 A “Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj” konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve ne linja elektrike dhe linjave te transmetimit, konkretisht për punimet si vijon:

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime ne linja elektrike te transmetimit		
F.V. Shtylla metalike 110 kV, dopio qark te zinguar me bullona	ton	338.88
Punime izolacioni 35 kV terheqes tek TT + morsete terh. ne shtylla ankerore (1 qark i montuar), 1x4 izolatore 12t	shtylle	10.5
Punime izolacioni 35 kV terheqes dopjo TD + morsete terh. ne shtylla ankerore (1 qark i montuar), 2x4 izolatore 12t	shtylle	2.5
Punime izolacioni 35 kV vares tek VT +morset mbajt. ne shtylla ndermjetese (1 qark i montuar), 1x3 izolatore 12t	shtylle	35
Punime izolacioni 35 kV vares dopjo VD +morset mbajt. ne shtylla ndermjet (1 qark i montuar), 2x3 izolatore 12t	shtylle	7
Shtrirje e terheqje 3 fije teli (percjellesa) me makineri, ACSR me seksion 240/40 mm <sup>2</sup>	km	17.50

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**  
**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

F.V. denfera ne linjat T/L 110kV ne shtylla ndermjetese (1 qark i montuar)	shtyllle	42
F.V. denfera ne linjat T/L 110KV ne shtylla ankerore tel terhequr (1 qark i montuar)	shtyllle	13
Shtrirje terheqje Trosi OPGW 63 mm <sup>2</sup> 24 fije ,Tipi G652	km	17.50
F.V. morseteri mbajttese per OPGW , ne linja 110 kV	shtyllle	42
F.V. morseteri terheqesee per OPGW , ne linja 110 kV	shtyllle	13
F.V Demfer per OPGW 63 mm <sup>2</sup>	shtyllle	55
F.V Joint Box per OPGW	cope	7
Tokezim Trosi per linja T/L 100 kV	shtyllle	55

**N.S. - 18 A Punime Gjeodezike.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 18 A “Punime topogjeodezike” Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të rilevimit topogjeodezik te nevojshem ne punimet praktike ne terren kuotat dhe piketimin e sheshit ku do te ndertohet ndertesa e re, bazamenteve te pajisjeve te rejat te N.Stacionit, si transformatoret e fuqise dhe pajisjet TL 110kV, kanale kablllo etj.

- Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime Gjeodezike		
Raporti gjeologjik, studimi sizmik i tokes	lot	1

**Argumentim** teknik për kërkesën mbi licencat profesionale në fushën e projektimit

Projektues konstruktor	- Pika 3/a,b
Projektues instalator	- Pika 4 / c
Projektim nenstacione elektrike, primar, sekondar – linja te tensionit te larte	- Pika 10/d

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

---

Në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit dhe zgjidhja që është kërkuar sipas termit “Turn key” që përfshin ndertimi i linjes re 35kV nga N.Stacioni Kavaje ne N.Stacionin Rrogozhine dhe realizimi i këtij projekti kërkon përfshirjen e stafit projektues të specializuar në fushën:

- Projektim konstruktor
- Projektues instalator
- Projektim nenstacione elektrike, primar, sekondar – linja te tensionit te larte.

Konkretisht, kërkohet që dokumentacioni i ofertës të përfshijë licencat ose marrëveshjet për këto kategori projektuesish:

**Projektues konstruktor** – Pika 3/a,b: për projektimin e strukturave mbajtëse si janë konstruksionet metalike elementet perberes te shtyllave te tensionit te larte.

**Projektues instalator** – Pika 4/c: për projektimin e instalimeve elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm brenda nënstacioneve, duke përfshirë pajisje ndërruese, ndarëse, mbrojtëse dhe sistemet e tokëzimit.

**Projektues për impiantet e shpërndarjes së energjisë elektrike** – Pika 10/d: për projektimin e linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike që përbëjnë rrjetin primar dhe sekondar.

Këto licenca përbëjnë një garanci teknike dhe ligjore që operatori ofertues ka kapacitetin profesional dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar projektimin e plotë sipas kërkesave të AK dhe ta zbatojë ato me sukses deri në perfundimin e punimeve, për këtë N.Stacion të rëndësishëm të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktojë disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe punimet përkatëse për objektin e prokurimit, këto janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### 2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune,
- Diplomën Universitare,
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dy punësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik inxhinier (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë :

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Montator (Të certifikuar për punime në lartësi) 6 (gjashtë)
- Punetore ndihmes 5 (pese)

Për punonjësit me profesionet si më sipër (përfshirë inxhinierët) , operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
-----	---------------------------------	------------	--	--

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**  
**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

1				
2				
3				
4				
5				

Për stafin teknik inxhinier si më sipër, ofertuesit duhet të paraqesin :

- Kontratë pune/ose kontrate sherbimi,
- Diplomën Universitare,
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Për punonjesit montator:

- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.
- Certificate e punimeve ne lartesi

Për punonjesit ndihmes:

- Kontratë pune/ose kontrate sherbimi,
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentim 2.3.3 – a.** Kërkesat e pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.

Numri i inxhinierëve, specialistëve dhe punonjesve sipas profesioneve perkatëse, është kërkuar duke parë klasifikimin dhe rëndësinë kushtet e vështira në lartësi që kanë ndertimi i linjave të reja

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

te Tensionit te Larte dhe duke respektuar gjithmone ne maksimum rregullat e sigurimit teknik ne zbatim.

Numri i tyre ne punimet e ndertimit te linjes eshte bazuar ne zerat dhe volumet e parashikuar ne punimet e preventivit, per arsyt e meposhtme:

Numri i kerkuar i nevojshem i punonjesve te mesiperm, eshte menduar edhe per arsye sigurie ne menyre qe punonjesit te mos jene te tejlohdhur nga puna, duke qene pune e veshtire fizikisht dhe ne kushte lartesis per kohe te gjate.

**Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me punimet per zbatimin e projektit te ndertimit te linjes se re te Tensionit te Larte.

**Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve civile objekt i kesaj kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në preventivin e kesaj linje te re, bazamentet e shtyllave te reja.

**Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanike si ne montime ashtu edhe ne qendrueshmerine dinamike dhe mekanike si te shtyllave, por edhe te percjellesve, si dhe kushtet atmosferike te motit sipas kushteve te projektimit qe linjat e Tensionit te Larte kane.

**Inxhinieri Gjeodet** eshte i nevojshem ne kete projekt per:

- Rilevimi topografik te linjes re.
- Piketimi i shtyllave TL
- Orientimi vertikal i strukturave te shtyllave.
- Matja e kuotave dhe shigjetës së varjes se percjellesit

**Inxhinieri Mjedisi** në linjat e tensionit të lartë luan një rol kyç në vlerësimin dhe minimizimin e ndikimit që këto infrastruktura kanë në ekosisteme, duke përfshirë monitorimin e rrezatimit elektromagnetik, mbrojtjen e faunës dhe bimesise dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes sipas detyrave te meposthme:

- **Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM):** Kryerjen e studimeve paraprake për të përcaktuar gjurmën e linjave të tensionit të lartë dhe impaktin e tyre në florë, faunë dhe zonat e banuara.
- **Menaxhimin e Rrezatimit Elektromagnetik:** Monitorimin e fushave elektromagnetike të lejuara sipas standerteve ndërkombëtare të sigurisë për shëndetin e njerezve dhe te mjedisit.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- **Mbrojtjen e Shpendëve dhe Kafshëve:**

**Montator (Të certifikuar për punime në lartësi)** është i nevojshëm për montimin e elementeve perberese te shtyllave dhe linja elektrike në lartësi në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik.

**Puntoret ndihmes** jane te nevojshem qe ne ndrejtimin e stafit inxhinierik elektrik, ndertimi te ndihmojne ne realizimn e punimve ndihmese si elektrike edhe ato civile ne realizmin e ketij objekti

- b) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratën e punës,
- Diplomën/certifikatën përkatëse.
- Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentim 2.3.3 - b.** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

c) Operatorët ekonomikë duhet që nga punonjësit e kërkuar më poshte:

- Montator (Të certifikuar për punime në lartësi) 6 (gjashtë)

duhet të jenë të pajisur me OMVK në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike.

- 4 (katër) punonjës specialist të pajisur me OMVK në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente të cilët duhet të kenë njohuri teorike dhe praktike të teknologjisë së instalimeve të tensionit të lartë dhe të rregullave që mundësojnë montimin, riparimin, mirëmbajtjen, çmontimin e instalimeve të tensionit të lartë në përputhje me kategorinë e tyre për elektrikist.
- 2 (dy) specialist të kenë kategorinë, e IV ose më e lartë dhe pjesa tjetër të jenë të pajisur me OMVK për elektrikist.

Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikat 2.3.3 (a/b), duhet të paraqesin edhe dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK.

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë shërbimi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve të VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetedeklarimit dhe dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik).*

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Lidhur me këtë pikë OE i klasifikuar i pari duhet të paraqesë:

- kontratën e individuale të punës / kontratën e shërbimit
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

**2.3.5** Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën Mars - Maj 2026 perjashtuar ata te cilet do te jene me kontrate sherbimi per periudhen e realizimit te objektit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars - Maj 2026.

**2.3.6** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarojnë të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	<b>Shtylla metalike</b>		
2.	<b>Percjelles ACSR 240/40mm<sup>2</sup></b>		
3.	<b>OPGW</b>		
4.	<b>Kabell 35kV percjelles Al, 1x300mm<sup>2</sup></b>		
5.	<b>Terminale te jashtme 35kV</b>		
6	<b>Shkarkues 35kV</b>		

**2.3.7** Operatorët ekonomikë ofertues duhet te paraqesin Autorizim te prodhuesit/Distributorit te autorizuar. Autorizimi duhet te përmbaje te dhëna te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

---

mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, për listën e mallrave të mëposhtëm:

1. Shtylla metalike
2. Percjelles ACSR 240/40mm<sup>2</sup>.
3. OPGW
4. Kabell fuqie TM, XLPE 35kV, percjelles alumini 1x300mm<sup>2</sup>.
5. Terminale te jashtme 35kV
6. Shkarkues 35kV

**2.3.8** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për materialet/pajisjet e ofruara, në formën e raporteve laboratorike nga laboratorë të akredituar, certifikatave të pajisjeve sipas standardeve EN/IEC/ISO,SSH, ose dokumenteve të tjera të vlefshme të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi/distributori i autorizuar ose ekuivalentet e tyre. Këto dokumente duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të ofruara (sipas listës së specifikimeve teknike ose materialeve të ngjashme) me kërkesat teknike dhe standardet e detyrueshme të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3.9** Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesë Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/për listën e materialeve te mësipërme qe do te ofrohen, ne te cilën te paraqiten te dhënat teknike baze.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojnë lehtësisht dhe qarte qe janë pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

**1.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur, ose me kontratë shërbimi për periudhën e kryerjes së punimeve të kontratës, me nje program te licencuar “PLS CADD and TOWER” ose te ngjashem ekuivalent, si dhe nje person te certifikuar per perdorimin e ketij programi.

Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin:

1. dëshmi/licence e paisjes me programin e licencuar / kontratën përkatëse të shërbimit
2. çertifikatat e punonjesit te certifikuar
3. listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**2.3.11** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 2.5 Ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
2.	Kamion me vinc $\geq 20$ ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
3.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
4.	Motoarganello	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5.	Makineri terheqje percjelles trosi, OPGW $\geq 35$ kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
6.	Makineri leshuese (frenuese) percj.,tros, OPGW $\geq 35$ kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7.	Falkone (pa motoarg.)	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
8.	Set veglash per kablo, (Motoprese Hidraulike) $\geq 35$ kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtëm :

Për mjetet që janë në pronesi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**2.3.12** Operoret ekonomik ofertues qe do te realizojnë këtë kontrate, duhet te jene te pajisur dhe të paraqesin certifikatat përkatëse te vlefshme ose ekuivalentet e tyre, te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, SSH EN ISO si me poshtë:

**Certifikatë SSH EN ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

**Certifikatë SSH EN ISO 45001:2023** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;

**Çertifikatë SSH EN ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “ Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Çertifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

**2.3.13** Operoret ekonomik ofertues duhet te plotesojne skeden teknike te pajisjeve sipas te dhenave te ofertuara.

**Realizimi i ketij projekti do te jete 20 muaj nga data e dorezimit te sheshit te ndertimit dhe do te jete sipas termit “çelësa ne dore” per arsyet e meposhtme:**

- ✓ Menaxhim me i thjeshtuar i projektit.
- ✓ Projektim i plote nepermjet softëare PLSCADD per llogaritje e shtyllave dhe percjellesit e tyre.
- ✓ Minimizon problemet teknike.
- ✓ Kontroll më i mirë i afateve.
- ✓ Kontroll më i mirë i cilësisë se pajisjeve.
- ✓ Zgjidhje me e shpejte e problemeve teknike.
- ✓ Reduktim i riskut për AK.
- ✓ Komisionim i shpejte dhe plote i pajisjeve dhe sistemit

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente*

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

*mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

**Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO ose cdo ekuivalent tjetër.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Reflektim: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të**

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

---

përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

**Shenim: Kudo që është përdorur fjala ”importi” zëvendësohet ”importi ose ekuivalent”**

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjerat duhet të shoqerohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe;

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 2 vite pas kolaudimit të punimeve.

Dokumentat e leshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vertetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vlerën Apostile, të datës 05.10.1961;

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njësia e Prokurimit bëri llogaritjen e afateve dhe vendosi që duke filluar nga data e hedhjes në sistem data e fundit e pranimit të ofertave dhe e zhvillimit të prokurimit të jetë data 06.07.2026 ora 11.00

Personi i autorizuar për të ngarkuar në sistem DST dhe gjithë dokumentat e tenderit do të jetë Z. Aleksandër Pjetri.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

❖ Njësia e Prokurimit

• Aleksandër Pjetri

Përgjegjës prokurimi

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

---